



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË

PROJEKT VENDIM

Nr.____, datë____,____,2026

Për

“Miratimin e dokumentit”Plani Vendor i Emergjencave Civile, bashkia Kolonjë” i rishikuar dhe i harmonizuar me “Planin Kombëtar për Emergjencat Civile”, planin e qarkut dhe planet vendore për emergjencat civile të bashkive fqinje sipas kërkesave të nenit nr.14 “Planet për emergjencat civile”, të Ligjit Nr.45/2019, datë 18.07.2019 “Për Mbrojtjen Civile”.

Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 ”Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar, nenit 14 “Planet për Emergjencat Civile”, nenit nr. 30 ”Bashkitë”, shkronja”ç”, të Ligjit Nr.45/2019 datë 18.07.2019 “Për Mbrojtjen Civile”, për përditësimin dhe miratimin e dokumentit “Plani Vendor i Emergjencave Civile”, i përditësuar me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshillit Bashkiak në mbledhjen e datës / 06/2026;

PROPOZOJ:

1.Miratimin e dokumentit “Plani Vendor i Emergjencave Civile, Bashkia Kolonjë”, i rishikuar dhe i harmonizuar me Planin Kombëtar për Emergjencat Civile, planin e qarkut dhe planet vendore për emergjencat civile të bashkive fqinje sipas kërkesave të nenit 14 “Planet për Emergjencat Civile”.

2.Ky dokument të konsiderohet si një dokument themelor për planifikimin dhe zbatimin e politikave për parandalim, minimizim fatkeqësish dhe për zhvillimin urban në territorin e bashkisë Kolonjë. Dokumenti të publikohet dhe të përdoret si referencë në hartimin e planeve dhe strategjive të tjera zhvëllimore.

3. Për zbatimin e këtij vendi ngarkohen të gjitha Drejtoritë dhe sektorët, në bashkinë Kolonjë.

Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Institucioni i Prefektit.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr. 394 Prot

Ersekë, më 24.06.2026

RELACION

**“ PËR MIRATIMIN E PLANIT VENDOR PËR EMERGJENCAT CIVILE
NË BASHKISË KOLONJË ”**

KËSHILLIT BASHKIAK KOLONJË

Të nderuar këshilltarë,

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, nenit 14, nenit 30, pika “ç” të Ligjit Nr.45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”.

Ju informojmë:

Dokumenti i Planit Vendor të Emergjencave Civile përshkuan punën e bërë në detyrimet që rrjedhin në nivel lokal, bazuar në ligjin nr.45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”. Ky dokument të konsiderohet si një dokument themelor për planifikimin dhe zbatimin e politikave për parandalim, minimizim fatkeqësish dhe për zhvillimin urban në territorin e bashkisë Kolonjë. Çdo njësi e vetë qeverisjes vendore, me vendim të këshillit bashkiak, hartojnë , përditësojnë dhe miratojnë minimalisht *jo më pak se një herë në çdo tre vjet planin vendor për emergjencat civile*. Plani vendor emergjencave civile për bashkinë Kolonjë është i harmonizuar me Planin Kombëtar për Emergjencat Civile, i miratuar me VKM Nr.807, datë 28.12.2023 dhe metodologjisë për hartimin e planeve për emergjencat civile, sipas shkresës së ardhur nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, me nr. prot 536/7, datë 10.11.2025 dhe shkresës sonë me nr. prot 6652, datë 19.11.2025.

Ky material u përgatit nga Bashkia Kolonjë dhe falënderime për Kryetarin e Bashkisë, z.Erion Isai, i cili ka qënë i angazhuar në procesin e përditësimit të dokumentacionit.

Materiali u përgatit duke ndjekur këto hapa:

Hapi i parë

Ngritja e grupit të punës në bashkinë Kolonjë, për hartimin e Planit Vendor për Emergjencat Civile.

Si pjesë përgatitore u zhvillua takimi me Kryetarin e Bashkisë Kolonjë, si dhe me stafin teknik për hartimin e dokumentit. Me Urdhër Nr. 51 datë 04.02.2026 u ngrit grupi i punës me përfaqësues nga Drejtoria e P.ZH.T.M, Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Pyjeve, Parqeve dhe Rekreacionit, Bordi i Kullimit, Sektori i MZSH-së, Emergjencave Civile, Drejtoria e Shërbimeve Publike, përfaqësues nga Zonat e Mbrojtura, Drejtori i Njësisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor. Në zbatim të urdhërit të Kryetarit të Bashkisë , u përgatit programi i punës për përditësimin e këtij plani.

Me Urdhër Nr. 91, datë 27.02.2026 u ngrit, Sekretariati Teknik për procesin e hartimit të draft dokumentacionit të Planit Vendor të Emergjencave Civile.

Hapi i dytë

Rishikimi i Kuadrit Ligjor Strategjik Kombëtar dhe Vendor.

• Dokumentet strategjike të mbrojtjes civile në nivel qendror:

1. **Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë (SKZRF)**, miratuar me VKM nr.94, datë 22.2.2023.
2. **Vlerësimi i Riskut nga Fatkeqësitë në Nivel Qendror (VRFNQ)**, miratuar me VKM nr.168, datë 24.3.2023.
3. **Plani Kombëtar për Emergjencat Civile**, miratuar me VKM nr.807, datë 28.12.2023.

• Dokumentet strategjike të mbrojtjes civile në nivel vendor:

1. Vlerësimi i Riskut nga Fatkeqësitë në Nivel Vendor (VRFNV), është një nga dokumentat strategjike i hartuar, i miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr.113, datë 30.10.2023.
2. Me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr.57, datë 28.6.2024”Për miratimin e Strategjisë Vendore për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë (SVZRF) në Bashkinë Kolonjë.
3. Me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr.101, datë 30.10.2024”Për miratimin e Planit Vendor për Emergjencat Civile, në bashkinë Kolonjë”.

• Qëllimet dhe objektivat e përgjithshme të PVEC, bashkia Kolonjë.

Nëpërmjet këtij plani synohet: zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë, realizimi i mbrojtjes civile për të garantuar mbrojtjen e jetës së njerëzve, minimizimin e dëmtimit të infrastrukturës, pronës, trashëgimisë kulturore, mjedisit gjatë emergjencave civile e fatkeqësive, nëpërmjet forcimit të sistemit të mbrojtjes civile.

Objektivat janë për të siguruar kushtet për institucionet shtetërore, publike dhe private për veprimtaritë ekonomike dhe për popullatën për kalimin nga gjendja normale e jetës dhe punës në një situatë emergjente apo fatkeqësie me humbje sa më ta vogla.

Garantimi i përdorimit të të gjitha burimeve të mundshme me qëllim sigurimin, ruajtjen e vazhdueshme të ekonomisë, lokalizimin e emergjencës civile dhe rimëkëmbjen pas fatkeqësisë.

Plani në thelb është një mjet bashkëpunimi. Objektivat specifike të këtij plani janë:

Adresa: Sheshi”Rilindja”Ersekë,7401,Kolonjë www.kolonja.gov.al, e-mail:info@kolonja.gov.al

- Të shpëtojë jetë njerëzore gjatë emergjencave civile ose fatkeqësive, duke zbatuar masat për evakuim, ofrim strehimi, lehtësojnë vuajtje, dhënien e ndihmës së parë.
- Mirëmbajtje e kanalizimeve, siguri i furnizimit me ujë, medikamente.
- Bashkërendim dhe mbështetje për grupet e kërkim-shpëtimit, të vullnetarëve.
- Mbrojtja e shëndetit dhe sigurisë së stafit të përfshirë në fazën e përgjigjes.
- Të risë ndikimin e kapaciteteve ekzistuese për minimizimin e dëmeve ndaj pronës , infrastrukturës, trashëgimisë kulturore, gjësë së gjallë, komuniteteve, mjedisit.
- Sigurimi i komunikimit të vazhdueshëm për dhënien e informacionit para, gjatë dhe pas një emergjence për komunitetin e prekur.
- Identifikimi dhe vlerësimi i risqeve, si dhe informimi i qytetarëve.
- Zhvillimi i trajnimeve rifreskuese vjetore me punonjësit dhe banorët, sipas moduleve dhe programeve të trajnimit.
- Të sigurojë mjetet për kërkimin e burimeve dhe ndihmë shtesë me personel, pajisje, furnizime për t'u përgjigjur në mënyrë efektive emergjencave civile.
- Garantimin e vazhdimësisë së përkujdesjes nëpërmjet të gjitha strukturave për të kufizuar efektet negative të emergjencës.
- Ndërmarrjen e vlerësimit pas emergjencave dhe stërvitjeve për të identifikuar mësimet e nxjerra dhe për të bërë përmirësimet e nevojshme në planin vendor për emergjencat civile, si dhe menaxhimin e emergjencave në të ardhmen.

Hapi tretë

Parimet e Funksionimit të PVEC.

1. Parashikueshmëria dhe gadishmëria.
 2. Vendimmarrja, lidhshëpi dhe pronësia.
 3. Informacioni.
 4. Integrimi dhe bashkëpunimi me grupet e interesit.
 5. Parimi i Subsidiaritetit.
 6. Përshtatja e Kuadrit Sendai, OZHQ-ve dhe Ndryshimeve Klimatike në Nivel Vendor.
- Në lidhje me parimin e parë, plani shtjellon një sërë veprimesh që lidhen në hark kohor afatmesëm (tre vjeçar). Duke evidentuar statistika të ngjarjeve, studime, parashikimeve të ndodhjes së ngjarjeve dhe menaxhimit të emergjencave.
 - Në lidhjen me parimin e vendimmarrjes është gur themeli për një emergjencëbazuar në elementët përbërës të një emergjence dhe interpretimit të saktë të saj.
 - Parimi i informacionit është shumë i rëndësishëm për të gjitha strukturat. Thelbësore është që publiku të marrë këshillat, paralajmërimet dhe informacionin e duhur për të afuar siguri dhe një bazë për çdo veprim të nevojshëm, gjatë menaxhimit të emergjencave.
 - Integrimi dhe bashkëpunimi me grupet e interesit. Emergjencat civile nuk njohin kufij, ndaj dhe përgatitja, përgjigja dhe rimëkëmbja nga emergjencat është një aktivitet ndërinstitutional që mund të përfshijë shumë organizata. Përfshirja, operacionet, roli dhe rëndësia relative e tyre

mund të ndryshojnë gjatë fazave të emergjencës. Është thelbësore që të integrohen kontributet e organizatave përkatëse. Strukturat mund të ndërveprojnë dhe të funksionojnë si një grup ndërinstitucional koherent, konsultohen, bien dakort, marrin vendime, nxjerin udhëzime, ndiqen nga partnerët përgjegjës ndaj emergjencave.

- Parimi i subsidiaritetit ose parimi *hap pas hapi* ka të bëjë kur institucioni i bashkisë mund të kërkojë mbështetje të bashkitë fqinje apo prefekti i qarkut, pasi të ketë ezauruar të gjitha kapacitetet brenda territorit administrative, duke përfshirë dhe subjektet private që ushtrojnë aktivitetin në territorin e bashkisë.

- Përshtatja e planit vendor për emergjencat civile e Bashkisë Kolonjë është në përputhje të plotë me kornizën ligjore dhe dokumentat ndërkombëtare në fushën e zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjes civile Përshtatja e Kuadrit Sendai, OZHQ-ve dhe Ndryshimeve Klimatike në Nivel Vendor.

Hapi i katërt

Sistemi i Mbrojtjes Civile në Nivel Qendror, në Nivel Qarku dhe në Nivel Vendor/Bashkie .

1. Institucionet dhe Strukturat Qendrore të Mbrojtjes Civile.

Kuvendi i Shqipërisë, Këshilli i Ministrave, Zyra Përgjegjëse për situatën, **Komiteti Ndërmintor i Emergjencave Civile**, Komiteti i Mbrojtjes Civile, Ministria përgjegjëse për Mbrojtjen Civile, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, Komisioni Teknik Këshillimor, Qendra e Mbrojtjes Civile në qark, Ministrinë dhe institucionet qendrore.

2. Institucionet dhe strukturat e Mbrojtjes Civile në nivel qarku.

Prefekti, Komisioni i Mbrojtjes Civile në nivel Qarku (KMCQ), Drejtuesi i Operacionit në nivel Qarku (DOQ), Qendra Operacionale e Emergjencave Civile në Qark(QOECQ), Sektori i Planifikimit, Sektori i Operacioneve, Sektori i Logjistikës, Komisioni i Mbrojtjes Civile në nivel Bashkie (KM CB).

3. Institucionet dhe strukturat e Mbrojtjes Civile në nivel bashkie.

Kryetari i Bashkisë, Komisioni i Mbrojtjes Civile në nivel bashkie, **Drejtuesi Operacional në nivel Bashkie, Qendra Operacionale e Emergjencave Civile në bashki (sektori operacional dhe i logjistikës)**, Strukturat Operacionale në nivel bashkie, Strukturat qendrore Operacionale në nivel bashkie, Strukturat e decentralizuara në nivel bashkie, Kryqi i Kuq, Vullnetarët, OJF, Donatorët, Grupet ndërkombëtare.

4. Financimi i sistemit të mbrojtjes civile në nivel bashkie.

Në nivel bashkie, sipas ligjit nr.45/2019, për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, si dhe për të kryer detyrat në zbatim të këtij ligji, mbështeten në garantimin minimal prej 4% të totalit të buxhetit të tyre vjetor, i cili sigurohet nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit. Bashkitë mund të planifikojnë fonde të tjera shtesë nga burimet financiare, si të ardhurat e tyre vendore, fondet që vijnë drejtëpërdrejtë nga shpërndarja e taksave dhe tatimeve kombëtare, huamarrja vendore, donacionet apo edhe burime të tjera të parashikuara në ligj.

Hapi i pestë

Nga grupi i punës u trajtuan katër fazat e ciklit të menaxhimit të emergjencave civile, të miratuara në nivel kombëtar nga AKMC, të cilat janë:

- 1.Parandalim/lehtësimi.
- 2.Gadishmëria (protokolli i komunikimit gjatë Emergjencave Civile).
- 3.Përgjigja, e cila ka disa etapa.
 - Etapa e I: Alarmi për rritjen e gadishmërisë
 - Etapa e II: Vendosja e gjendjes së gadishmërisë
 - Etapa e III: Aktivizimi
 - Etapa e IV: Dalja nga situata
- 4.Rimëkëmbja

Në të gjitha këto faza të ciklit të menaxhimit të emergjencave civile janë trajtuar përgjegjësitë e strukturave dhe institucioneve në nivel bashkie dhe nivel qendror.

Gjatë trajtimit të fazës së gadishmërisë, i jemi referuar dokumentit të vlerësimit të Riskut nga Fatkeqësitë, të bashkisë Kolonjë. Planivendor i Emergjencave Civile është dhe një mjet operacional.

Faza e rimëkëmbjes pason atë të përgjigjes emergjente dhe luan rol kyç në kthimin e komunitetit drejt normalitetit, në këtë fazë rol kyç merr planifikimi i zonave të emergjencës, duke parashikuar aktivitete afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata.

Hapi i gjashtë

Duke ju referuar Bazës së të Dhënave të Humbjeve nga Fatkeqësitë dhe risqeve të identifikuara në dokumentin e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë, në territorin e bashkisë Kolonjë u punua me skenarin e “Riskut nga zjarri” në ekonominë pyjore Leskovik si dhe “Riskun e bllokimit nga dëbora dhe rrëshqitja”.

Hapi i shtatë

Përgatitja, kontrolli për përputhshmërinë ligjore dhe miratimi i PVEC.

- Hartimi i Planit Vendor të Emergjencave Civile.

Së pari, u bë shkrimi i *draftit paraprak*, qarkullimi i këtij materiali në grupin teknik.

Së dyti, në procesin e komunikimit, të kalimit të informacionit, nëpërmjet takimeve në tryeza pune, por dhe në të gjitha kanalet, u tërhoq mendimi i punonjësve të tjerë të institucioneve, të Institucionit të AKMC, jo vetëm me ngritjen, por dhe forcimin e sistemit të mbrojtjes civile në nivel vendor në lidhje me nxitjen e procesit të përditësimit të planit vendor për mbrojtjen civile, i sygjerrimeve nga publiku gjatë procesit të konsultimit me publikun, duke realizuar *dokumentin e avancuar*, i cili është një dokument strategjik dhe operacional.

Së treti, përsa i përket kontrollit të përputhshmërisë ligjore kjo është realizuar nëpërmjet monitorimit të procesit të punës për arritjen e objektivit. Ky monitorim është realizuar me mjetet e komunikimit në formën shkresore, por dhe të raportimit javor të punës tek Kabineti i Kryetarit.

Së katërti, pas konfirmimit me datën 02.06.2026 nga Institucioni i AKMC, nëpërmjet adresës së e-mail të dërguar z. Sadik Balliu me detyrë Specialist në sektorin e Planifikimit të Mbrojtjes Civile, Drejtoria e Zvogëlimit të Riskut, Fatkeqësive dhe Parandalimit pasi u morën parasysh disa komente të vogla, u vazhdua me procedurën për konsultimin publik. Gjatë këtij procesi u dhanë sygjerrime nga inxh.Dhimitër Pina, për të cilat e falënderojmë dhe do të merren në konsideratë, jo vetëm në përditësimin e dokumentave por dhe në masa strukturore për zvogëlimin rreziqeve.

Hapi i tetë

➤ Miratimi i PVEC.

Në Ligjin Nr . 45/2019 "Për Mbrojtjen Civile", është përcaktuar se Plani Vendor për Emergjencat Civile miratohet me Vendim të Këshillit Bashkiak.

Me konfirmimin e bazueshërisë ligjore, nga institucioni i Prefektit, plani vendor i emergjencave civile do ti dërgohet Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe Prefektit të Qarkut, për qëllime analizimi dhe planifikimi.

Plani Vendor i Emergjencave Civile është plani për përgatitjen, parandalimin, mbrojtjen, shpëtimin dhe ndihmën në rast të një fatkeqësie natyrore ose të një fatkeqësie tjetër, i hartuar në bazë të vlerësimit të risqeve. Procesi i hartimit të hartave, u bë nga specialisti GIS, në bashkinë Kolonjë.

Përsa i përket testimit të planit, për menaxhimin e fatkeqësive, do të zbatohen masa të përgatitjes, përgjigjes ndaj fatkeqësive dhe të rimëkëmbjes prej tyre të përcaktuara në strukturat, në rolet dhe përgjegjësitë që ata kanë.

➤ Rishikimi, Përditësimi dhe Mirëmbajtja e PEC.

Rishikimi, përditësimi dhe mirëmbajtja e planit do të bëhet duke ju referuar kuadrit ligjor të përcaktuar si dhe gjatë përballjes me fatkeqësitë natyrore që mund të prekin territorin e bashkisë Kolonjë.

Për të gjitha arsyet e trajtuara më sipër, propozojmë:

1. Miratimin e planit vendor të emergjencave civile për bashkinë Kolonjë .
2. Për zbatimin e këtij vendimi detyrohen të gjitha institucionet e Bashkisë Kolonjë, pasi është përgjegjësi për të gjitha fushat.

Duke **JU** falënderuar për bashkëpunimin.

Grupi i punës:

1. Petro Risto _____
2. Ristana Gjergo _____
3. Muharem Tartari _____
4. Ganiart Eminaj _____
5. Origest Lifo _____
6. Petro Kristo _____
7. Sotir Veizi _____
8. Mimoza Gora _____
9. Jorgji Duka _____
10. Elson Guçe _____
11. Brikena Aliu _____
12. Elton Orhanas _____
13. Pando Çunge _____
14. Vladimir Dhespollari _____
15. Kledia Brame _____

KRYETARI
Erion Isai

